



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E OBJEKTEVE PUBLIKE
TITULLARI AUTORITETIT KONTRAKTOR

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____, _____, 2024

Shtojca 12

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT
(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

Drejtuar: RAFIN COMPANY SHPK me NIPT L52125110A me adresë; Tiranë, Rruga "Haxhi Kika"
Njësia Administrative Nr.5, Nr.pasurie 6/538, Hyrja 1, Apartamenti 4.

Procedura e prokurimit/lotit: E hapur, mbi kufirin e lartë monetar

Numri i procedurës/referenca e Lotit: REF-01414-04-15-2024

Përshkrimi i shkurtër i kontratës:

Objekti: "Shpenzime për mirëmbajtjen e objekteve specifike"

Fondi limit: 62 409 264 (gjashtëdhjetë e dy milion e katërqind e nëntë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e katër) Lekë pa Tvsh.

Kohëzgjatja e kontratës: 12 (dymbëdhjetë) muaj

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

- 1. Operatori ekonomik Mela sh.p.k me NIPT K62320011G**, me ofertë ekonomike 48 390 970 (dyzet e tetë milion e treqind e nëntëdhjetë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë) Lekë pa Tvsh.
- 2. Operatori ekonomik I 2 A sh.p.k me NIPT M11630006B**, me ofertë ekonomike 60 346 090 (gjashtëdhjetë milion e treqind e dyzet e gjashtë mijë e nëntëdhjetë) Lekë pa Tvsh.
- 3. Bashkimi i operatorëve ekonomikë Valona Konstruksion sh.p.k me NIPT K26330202E dhe Zeqillari sh.p.k me NIPT L61912024O** me ofertë ekonomike 57 992 000 (pesëdhjetë e shtatë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë mijë) Lekë me Tvsh.

4. **Operatori ekonomik Shendelli sh.p.k me NIPT K07924803N** me oferte ekonomike **62 113 900** (*gjashtëdhjetë e dy milion e njëqind e trembëdhjetë mijë e nëntëqind*) **Lekë pa Tvsh.**
5. **Operatori ekonomik Rafin Company sh.p.k me NIPT L52125110A**, me ofertë ekonomike **52 671 700** (*pesëdhjetë e dy milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e një mijë e shtatëqind*) **Lekë pa Tvsh.**

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

- A) Gjatë shqyrtimit të ofertës së operatorit ekonomik **Mela sh.p.k me NIPT K62320011G**, me oferte ekonomike **48 390 970** (*dyzet e tetë milion e treqind e nëntëdhjetë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë*) **Lekë pa Tvsh**, Komisioni i Hapjes dhe Vlerësimit të Ofertave konstatoi se kriteret e veçanta dhe të përgjithshme sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentat standarte të tenderit (DST) të cilat nuk i plotëson janë si më poshtë;
1. Operatori ekonomik MELA Sh.p.k, nuk plotëson pikën **2.3.1** të kapacitetit teknik të DST, pasi nuk plotëson 40% të vlerës së kërkuar të kontratës së ngjashme. Operatori ekonomik ka dorëzuar në SPE kontratën Nr.2442 prot. date 13.10.2020 me Autoritet Kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit, me objekt “Rehabilitimi i lagjeve 4,5 dhe 6 të Bashkisë Kukës” me vlerë **276 031 718** (*dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë milion e tridhjetë e një mijë e shtatëqind e tetëmbëdhjetë*) **Leke me Tvsh**. Referuar akt-marreveshjes së bashkëpunimit dhe ndarjes së % operatori ekonomik MELA sh.p.k disponon 16% të kontratës praktikisht 36 804 229.06 (tridhjetë e gjashtë milion e tetëqind e katër mijë e dyqind e njëzet e nëntë) **Leke pa Tvsh**. Referuar zerave të punimeve në preventivin e punimeve objekt prokurimi dhe referuar zerave të punimeve që ka realizuar në kontratën Nr.2442 prot. date 13.10.2020 me Autoritet Kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit, me objekt “Rehabilitimi i lagjeve 4,5 dhe 6 të Bashkisë Kukës” rezulton se vlera totale e punimeve është **9 196 653** (*nente milion e njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë gjashtëqind e pesëdhjetë e tre*) **Leke me Tvsh**. Në përmbushje të pikës 2.3.1 Vlera e kërkuar për plotësim në pikën 2.3.1 duhet të jetë **24 963 705.6** (*njezet e katër milion e nentëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e shtatëqind leke e pese*) **Leke pa Tvsh**, realizuar gjatë tre viteve të fundit. Operatori ekonomik Mela sh.p.k nuk plotëson vlerën e kërkuar 40% të kontratës së ngjashme.
 2. Operatori ekonomik MELA Sh.p.k, ka deklaruar në Formularin Përmbledhës së Vetdeklarimit se në plotësim të pikës **2.3.4** *Operatori ekonomik duhet të paraqesë një dëshmi nga administrata tatimore për punësimin mesatar të jo më pak se 152 (njëqind e pesëdhjetë e dy) punonjësve për periudhën Janar 2024 - Mars 2024 dhe në vazhdim, të vërtetuar me dokumentacionin si vijon.....* është mbështetur në subjektet KLAME sh.p.k dhe VAGALAT sh.p.k konkretisht në 83 punonjës nga operatori ekonomik VAGALAT dhe 15 punonjës nga operatori ekonomik KLAME sh.p.k. Referuar Neni 90 të V.K.M RPP Nr.285 ku “Mbeshtetja në kapacitetet e subjekteve të tjera pika 2, *Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet: Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor.* Operatori ekonomik MELA sh.p.k ka deklaruar në Formularin Përmbledhës së Vetdeklarimit se disponon 55 punonjës. Pra $150 \cdot 0.5 = 75$ (pra nuk duhet të tejkalohet numri 75 për ta marrë me mbështetje.

Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të nenit 92 të Ligjit nr.162/2020 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 82 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të

prokurimit publik” si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, u konstatua se oferta e operatorit ekonomik **Mela sh.p.k me NIPT K62320011G**, nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e cilësuar si **ofertë të pavlefshme**.

B) Gjatë shqyrtimit të ofertës së operatorit ekonomik **I 2 A sh.p.k me NIPT M11630006B**, me ofertë ekonomike **60 346 090** (*gjashtëdhjetë milion e treqind e dyzet e gjashtë mijë e nëntëdhjetë*) **Lekë pa Tvsh**, Komisioni i Hapjes dhe Vlerësimit të Ofertave konstatoi se kriteret e veçanta dhe të përgjithshme sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentat standarte të tenderit (DST) të cilat nuk i plotëson janë si më poshtë;

1. Operatori ekonomik I 2 A sh.p.k, nuk plotëson pikat **2.3.2, 2.3.3, 2.3.4, 2.3.5, 2.3.6, 2.3.7, 2.3.10**, të kapacitetit teknik të DST, pasi sipas deklaratimit në Formularin Përmbledhës të Vetdeklarimit nuk përmbushen kriteret e kërkuara.
2. Operatori ekonomik I 2 A sh.p.k, nuk plotëson pikën **2.3.1**, të kapacitetit teknik të DST, në lidhje me kontratën e ngjashme të paraqitura në SPE.
3. Operatori ekonomik I 2 A sh.p.k, nuk plotëson pikën **2.3.8** dhe **2.3.9** të kapacitetit teknik të DST, pasi nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për plotësimin e këtij kriteri.
4. Operatori ekonomik I 2 A sh.p.k, nuk plotëson pikën **2.3.10** të kapacitetit teknik të DST, pasi nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për plotësimin e këtij kriteri.

Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të nenit 92 të Ligjit nr.162/2020 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 82 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, u konstatua se oferta e operatorit ekonomik **I 2 A sh.p.k me NIPT M11630006B**, nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e cilësuar si **ofertë të pavlefshme**.

C) Gjatë shqyrtimit të ofertës së operatorit ekonomik **Shendelli sh.p.k me NIPT K07924803N** me oferte ekonomike **62 113 900** (*gjashtëdhjetë e dy milion e njëqind e trembëdhjetë mijë e nëntëqind*) **Lekë pa Tvsh**, Komisioni i Hapjes dhe Vlerësimit të Ofertave konstatoi se kriteret e veçanta dhe të përgjithshme sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentat standarte të tenderit (DST) të cilat nuk i plotëson janë si më poshtë;

1. Operatori ekonomik Shendelli sh.p.k, nuk plotëson pikën **2.3.1** të kapacitetit teknik të DST, pasi kontrata e ngjashme e paraqitur në SPE, nuk përmbush afatin 3 vjeçar të realizimit.
2. Operatori ekonomik Shendelli sh.p.k, nuk plotëson pikën **2.1.5** të kapacitetit profesional të DST, pasi nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për plotësimin e këtij kriteri.
3. Operatori ekonomik Shendelli sh.p.k, nuk plotëson pikën **2.3.8** dhe **2.3.9** të kapacitetit teknik të DST, pasi nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për plotësimin e këtij kriteri.
4. Operatori ekonomik Shendelli sh.p.k, nuk plotëson pikën **2.3.4** të kapacitetit teknik të DST, pasi ka deklaruar në Formularin Përmbledhës të Vetdeklarimit se ka deklaruar se ka të punësuar 80 punonjës, pra se plotëson numrin e kërkuar të punonjësve sipas DST.

Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të nenit 92 të Ligjit nr.162/2020 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 82 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, u konstatua se oferta e operatorit ekonomik **Shendelli sh.p.k me NIPT K07924803N**, nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e cilësuar si **ofertë të pavlefshme**.

D) Gjatë shqyrtimit të ofertës së Bashkimit të operatorëve ekonomikë **Valona Konstruksion sh.p.k me NIPT K26330202E dhe Zeqillari sh.p.k me NIPT L61912024O** me ofertë ekonomike **57 992 000** (pesëdhjetë e shtatë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë mijë) **Lekë me Tvsh**, Komisioni i Hapjes dhe Vlerësimit të Ofertave konstatoi se kriteret e veçanta dhe të përgjithshme sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentat standarte të tenderit (DST) të cilat nuk i plotëson janë si më poshtë;

1. Bashkimi i operatorëve ekonomikë Valona Konstruksion sh.p.k & Zeqillari sh.p.k, nuk plotëson pikën 2.3.1 të kapacitetit teknik të përcaktuar në dokumentat standarte të tenderit (DST), në lidhje me kontratat e ngjashme, pasi në zbatim të Nenit 88 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), parashikohet shprehimisht se:

1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2. Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.

*3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. **Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.***

Përsa më sipër operatori ekonomik Zeqillari sh.p.k pjesë e BOE, sipas Kontratës së Bashkëpunimit ka marrë përsiper të realizojë 12% të shërbimeve të objektit të prokurimit. Në raport me % e deklaruar operatori ekonomik Zeqillari sh.p.k nuk plotëson vlerën e kontratës së ngjashme. Konkretisht referuar zerave të shërbimeve që ky operator ka marrë përsiper për realizim sipas Kontratës së bashkëpunimit përkatesisht ndarjes në % dhe në vlerë, në dokumentin e paraqitur Ndarja e shërbimeve vlera që duhet të plotësohet ky operator ekonomik duhet të ishte **2 783 616** (dy milion e shtatëqind e tetëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e gjashtëmbëdhjetë) **Lekë pa Tvsh**.

Në kontratën e ngjashme të paraqitur nga ana e operatorit ekonomik Zeqillari sh.p.k, Nr.repertori 9299 dhe Nr. Koleksioni 6160 datë 23.09.2022 me objekt “Ndërtim i një kompleksi agroturistik me qëllim ofrimin e shërbimeve B&B dhe ambienteve të tjera argetuese dhe shpłodhese”, referuar zerave konkrete të punimeve objekt prokurimi që ky operator ka realizuar në total janë **2 555 708** (dy milion e pesëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e tetë) **Lekë pa Tvsh**, vlerë e cila nuk e përmbush detyrimin e operatorit për vlerën e kërkuar në raport me % që ka marrë përsiper në këtë bashkim operatorësh ekonomike.

2. Bashkimi i operatorëve ekonomikë Valona Konstruksion sh.p.k & Zeqillari sh.p.k, nuk plotëson pikën 2.3.5 të kapacitetit teknik të përcaktuar në dokumentat standarte të tenderit (DST), në lidhje me punonjësit e këkuar, pasi në zbatim të Nenit 88 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar),

Përsa më sipër, Operatori ekonomik Zeqillari sh.p.k pjesë e BOE, sipas Kontratës së Bashkëpunimit ka marrë përsiper të realizojë 12% të shërbimeve të objektit të prokurimit. Në raport me % e deklaruar si dhe në raport me Ndarjen e zërave të shërbimit të deklaruar, operatori ekonomik Zeqillari sh.p.k, referuar Formularit Përmbledhës të Vetdeklarimit ka deklaruar se disponon 2 punonjes bojaxhi. Konstatohet se ky operator nuk ploteson numrin e punonjesve bojaxhi në raport me % e deklaruar dhe ndarjen e zërave të shërbimit sepse sipas llogaritjeve duhet të kishte minimumi 3 punonjës bojaxhinj, nga 26 punonjës bojaxhinj të kërkuar në total.

3. Bashkimi i operatorëve ekonomikë Valona Konstruksion sh.p.k & Zeqillari sh.p.k, nuk plotëson pikën 2.3.10 të kapacitetit teknik të përcaktuar në dokumentat standarte të tenderit (DST), në lidhje me kapacitetet e këkuara, pasi në zbatim të Nenit 88 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), pasi operatori ekonomik Zeqillari sh.p.k referuar kontratës së bashkëpunimit dhe ndarjes së shërbimeve që secili prej operatorëve ekonomikë ka marrë përsiper të realizojë, ka marrë përsiper zërat e shërbimeve si më poshtë vijon:

- 2.431 Skela metalike me tubo për fasadë ~ 8 m
- 2.429 Skela metalike me tubo për tavan ~ 8 m

Por në Formularin Përmbledhës të Vetdeklarimit të ngarkuar në SPE, ky operator ekonomik nuk ka deklaruar se posedon Skeleri metalike. Pra operatori ekonomik Zeqillari sh.p.k nuk disponon kapacitetet për të realizuar shërbimet e marra përsiper në lidhje me objektin e prokurimit.

Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të nenit 92 të Ligjit nr.162/2020 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 82 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, u konstatua se oferta e bashkimit të operatorëve ekonomikë **Valona Konstruksion sh.p.k me NIPT K26330202E dhe Zeqillari sh.p.k me NIPT L61912024O**, nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e cilësuar si **ofertë të pavlefshme**.

* * *

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, ju informojmë se operatorët ekonomikë të mëposhtëm janë identifikuar si fitues (paraparak) të procedurës së prokurimit:

1. **Rafin Company sh.p.k me NIPT L52125110A**, me ofertë ekonomike **52 671 700** (*pesëdhjetë e dy milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e një mijë e shtatëqind*) **Lekë pa Tvsh, kualifikohet në vend të parë si ofertë e suksesshme.**

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik **Rafin Company sh.p.k me NIPT L52125110A** dhe me adresë; Tiranë, Rruga “Haxhi Kika” Njësia Administrative Nr.5, nr.pasurie 6/538, Hyrja 1, Apartamenti 4, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **52 671 700** (*pesëdhjetë e dy milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e një mijë e shtatëqind*) **Lekë pa Tvsh**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve Publike Tiranë me adresë Rruga “5 Maji”, God.17, Tiranë, Tel.: 042227376, e-mail: dpn3@tirana.al, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe procedura e prokurimit do të anulohet, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak):

PO JO

Vendim i Komisionit të Prokurimit Publik Nr.787/2024 datë **02.07.2024**, ku është vendosur përfundimi administrativ në lidhje me ankesën për procedurën e prokurimit publik me objekt “Shpenzime për mirëmbajtjen e objekteve specifike”, si dhe vijimi i procedurës së prokurimit publik nga ana e Autoritetit Kontraktor.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

OLSI ISUFAJ